



BASHKIA  
TIRANË  
**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 177, datë 31.12.2020**

**“PËR  
MIRATIMIN E LISTAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, QË PËRFITOJNË BURSA DHE  
PAGESA, PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

**1.** Miratimin e listës së nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, për vitin shkollor 2020 – 2021, sipas parashikimeve të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, sipas Shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**ROMINA KUKO**